



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Ko Med LLC” të datës 21.05.2025 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 20.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje mjekësore për QKMF dhe QMU LOT 2” me nr. të prokurimit 616-25-695-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Ko Med LLC” të datës 21.05.2025 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 20.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje mjekësore për QKMF dhe QMU LOT 2” me nr. të prokurimit 616-25-695-1-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Ko Med” LLC (tutje “parashtruesi”) me datë 21.05.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 20.05.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje mjekësore për QKMF dhe QMU LOT 2” me nr. të prokurimit 616-25-695-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Pas qasjes ne dokumentacion te Operatorit Ekonomik te rekomanduar per kontrate kemi verejtur se operatori i rekomanduar ne oferten e tij është i papërgjegjshëm sepse nuk i përmbush specifikat teknike sipas dosjes së tenderit: 1.EKG me monitor:-Tastierë alfanumerike - Nuk ka tastierë alfanumerike (siç është kërkuar në specifikat e dosjes se tenderit)- Ndjeshmëria: 2,5/5/10/20 mm/Mv – është ofruar nga 5/10/20 mm/mV- Mungon Ngarkimi automatik i letrës-Mungon Mundësia e dërgimit të ekzaminimit EKG dhe të dhënave mjekësore me e-mail direkt nga pajisja 3. Ambu baloni per dhenien e frymëmearrjes per te rritur dhe femije: Është kërkuar që të jen madhësitë e të rriturve dhe fëmijëve Vëllimi i trupit 300 1700 CC (është ofruar nga 500-1600 CC).Nuk ka ofruar Ambu balon me vëllim më të vogël se 500CC. 8.EMT scissors: Jan ofruar Lister Scissors 18 cm te cilat nuk perputhen me dimesionet e kerkuara dhe kan perdorim tjeter prej EMT Emergency Scissors. Gërshërët lister perdoren për heqjen e fashave dhe gazave ndërsa Emergency scissors përdoren për të prerë rroba , rripa sigurimi apo këpucë në raste urgjente. 11.Emergency Bag: Nuk ka ofruar produktet: 1.Gjerësia e levës Hohmann 24mm-28 cm 2.Pin sigurie Mayo 14.0CM 3.Hartmann Forceps Lakuar 10 cm 13.Barele Traumatike Është ofruar produkt krejtsisht tjeter me atë që është kërkuar në dosjen e tenderit. Nuk perputhet me dimensionet e kerkuara. Nuk e ka mekanizëm efikas të fiksimit dhe shkëputjes për shkyçjen e barelës; një gjatësi barele e rregullueshme me një mekanizëm mbyllës të automatizuar Nuk i ka tre rripa sigurie me shkëputje të shpejtë për imobilizimin e pacientëve".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore ashtu që është konfirmuar se tenderuesi i rekomanduar për kontratës nuk është në përputhje të plotë me specifikat teknike të DT. Prandaj kërkesa për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi, duke kthyer aktivitetin e prokurimit në rivlerësim me ç'rast komisioni për rivlerësim duhet të ndërmerr masat dhe veprimet e nevojshme për ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e ofertave sipas DT dhe LPP në fuqi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 23.05.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.